

UDHËZIM
Nr.2, datë 14.5.2009

**PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR MIRATIMIN E
MATERIALEVE TË PËRKTHYERA TË LEGJISLACIONIT TË BASHKIMIT
EUROPIAN NË SHQIP**

Në mbështetje të nenit 118 të kushtetutës, ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”, pikave 5 dhe 9 me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 7.3.2007 “Për përcaktimin e procedurave të përkthimit të legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe të përkthimit të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit European”, Ministri i Integritimit

UDHËZON:

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për ngritjen dhe funksionimin e komisioneve të posaçme, të cilët do të vlerësojnë dhe miratojnë përkthimin në gjuhën shqipe të legjislacionit europian.

2. Komisioni i posaçëm është komision me karakter *ad hoc*, i cili ngrihet me urdhër të Ministrit të Integritimit, bazuar në pikën 5 me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 7. 3. 2007 “Për përcaktimin e procedurave të përkthimit të legjislacionit të Bashkimit European në gjuhën shqipe dhe të përkthimit të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit European”.

2.1 Ministri i Integritimit në fillim të çdo viti, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Përkthimit të Legjislacionit European, përcakton komisionet dhe emëron anëtarët e tyre. Në këtë akt do të përcaktohen kapitujt/nënkapitujt e *Acquis Communautaire*, që do të mbulojë një komision, si dhe funksionet përkatëse të secilit prej anëtarëve.

2.2 Çdo komision përbëhet nga:

- a) dy ekspertë të Ministrisë së Integritimit me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm;
- b) një ekspert i ministrisë së linjës apo institucionit qendror sipas fushave përkatëse të akteve ligjore të shqyrtuara, që caktohet nga këta të fundit me kërkesë të Ministrisë së Integritimit brenda muajit janar; si dhe
- c) dy ekspertë të jashtëm që caktohen nga Ministria e Integritimit, me propozim të universiteteve dhe instituteve shkencore e kërkimore ose përzgjidhen individë të shquar të fushës përkatëse.

2.3 Komisioni drejtohet nga njëri prej përfaqësuesve të Ministrisë së Integritimit, i përcaktuar si i tillë në aktin e emërimit.

3. Komisioni ka këto detyra kryesore:

- a) shqyrton në tërësi materialet e përkthyer të legjislacionit europian në gjuhën shqipe;
- b) kontrollon dhe përmirëson materialet e përkthyer: nga përmbajtja, forma, uniformiteti e terminologjia, në përputhje me standardet e përcaktuara dhe bëra me dije nga Ministria e Integritimit;
- c) siguron unifikimin e terminologjisë së përdorur, në përputhje me standardet e përcaktuara nga Ministria e Integritimit;
- ç) përcakton terminologjinë e fushës dhe ia bën me dije Ministrisë së Integritimit.

4. Anëtarët e komisionit nga Ministria e Integritimit, ministrët e linjës dhe institucionet e tjera qendrore duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

- a) të kenë eksperiencë në fushën përkatëse, përbën avantazh njohja e legjislacionit europian në atë fushë;
- b) të kenë njohuri shumë të mira të njëres prej gjuhëve zyrtare të BE-së, përbën avantazh

njohja e një gjuhe të dytë;

c) të kenë aftësi shumë të mira komunikimi dhe të punës në grup;

ç) përbëjnë avantazh studimet e thelluara në fushën përkatëse, si dhe pjesëmarrja në grupe pune mbi përafrimin e legjislacionit ose në grupin negociator.

5. Anëtarët e komisionit, si ekspertë të jashtëm, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

a) të kenë eksperiencë në fushën përkatëse, përbën avantazh njohja e legjislacionit europian në fushën përkatëse;

b) të kenë jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune në fushën përkatëse;

c) të kenë njohuri shumë të mira të njërës prej gjuhëve zyrtare të BE-së, përbën avantazh njohja e një gjuhe të dytë;

ç) të kenë tituj dhe grada shkencore;

d) të kenë aftësi shumë të mira komunikimi dhe të punës në grup.

6. Komisioni ushtron detyrat e tij brenda periudhës kohore, të përcaktuar në urdhrin e Ministrit të Integrimit.

6.1 Komisioni mbledhet sa herë e shikon të nevojshme brenda periudhës kohore, të përcaktuar në urdhrin e Ministrit të Integrimit.

6.2.1 Drejtuesi i komisionit ka këto funksione kryesore:

a) organizon mbledhjet e komisionit;

b) drejton mbledhjet e komisionit;

c) koordinon punën ndërmjet anëtarëve të komisionit;

d) mban kontakte me Drejtorinë e Përkthimit të Legjislacionit Europian pranë Ministrisë së Integrimit;

e) mban procesverbalin e mbledhjeve.

6.3 Komisioni në mbledhjen e tij të parë vendos për organizimin e punë dhe ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve në përputhje me urdhrin e Ministrit të Integrimit.

7. Vendimi i marrë pasqyrohet në një procesverbal dhe firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit.

7.1 Aktet e miratuara nga komisioni, së bashku me procesverbalin përkatës, i dërgohen Drejtorisë së Përkthimit të Legjislacionit Europian për rishikimin përfundimtar.

8. Anëtarët e komisionit nga ministrinë e linjës dhe institucioneve të tjera qendrore, si dhe ekspertët e jashtëm, do të shpërblehen për punën e kryer në bazë të numrit të faqeve të shqyrtuara prej tyre.

8.1 Pagesa e anëtarit nga ministrinë e linjës dhe institucioneve të tjera qendrore do të jetë 200 lekë për çdo faqe të shqyrtuar; ndërsa pagesa për ekspertët e jashtëm do të jetë 400 lekë për çdo faqe të shqyrtuar.

9. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përkthimit të Legjislacionit Europian.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INTEGRIMIT
Majlinda Bregu